



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.285/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.285/2025 dhe Anr.287/2025 datë 31.01.2025.
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3,500.00 Euro (tremijepesëqind) Euro.
- III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.258/2025 dhe Anr.287, të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se më 31 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësira/ndërtesa publike të kandidatës për deputete për subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), Lisa Rugovaj, të vendosur mbi urën publike ku kalojnë këmbësor, në rrugën “ Agim Çelaj”, në lagjen Fidanishte në Pejë. Ndërsa në ankesën Anr. 287/2025 pretendohet se po të njëjtën datë kanë identifikuar baner/poster të kandidatet për deputete të LDK-së, Bahrije Hyseni, në rrugën publike “Hysen Statovci” në Fshatin e Vjetër në Ferizaj, e vendosur në shtyllën elektrike dhe ndriçuese të rrugës.

Në vazhdim thuhet se me këtë veprim kandidatet dhe subjekti politik LDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, LZP. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë, fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Kërkojnë nga paneli që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik LDK, thekson se kandidatja Lisa Rugovaj posedon një pëlqim nga Drejtoria kompetente e Komunës së Pejës, për vendosjen e banerit në rrugën "Agim Qelaj" në Pejë, në lagjen Fidanishte. Ndërsa kandidatja Bahrije Hyseni ka evituar shkeljen e pretenduar brenda afatit kohor 24 orësh dhe ka larguar posterin e vendosur në hapsirë publike në rr. Hysen Statovci" në fshatin e Vjetër në Ferizaj. Kërkojnë nga PZAP-i që ankesat e subjektit LVV të refuzohen të pabazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.285/2025 dhe Anr.287/2025, të paraqitura me datë 31.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.285/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik LDK, ka vendosur posterat e kandidateve për deputete nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lisa Rugovaj dhe Bahrije Hyseni në hapësirat publike, konkretisht në mbi urën publike ku kalojnë këmbësor, në rrugën " Agim Çelaj", në lagjen Fidanishte në Pejë dhe në rrugën publike "Hysen Statovci" në Fshatin e Vjetër në Ferizaj, e vendosur në shtyllën elektrike dhe ndriçuese të rrugës, dhe më të njëjtin veprim subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parashihet: "*1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Me përgjigjen në ankesë për rastin Anr.285/2025, është pretenduar se vendosja e posterit është bërë me pëlqim të përkohshëm për shfrytëzim të hapësirës publike të lëshuar nga Komuna e Pejës, Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike, mirëpo Paneli vlerëson se pëlqimi i referohet një rruge tjetër nga ajo që pretendohet në ankesë së është vendos posterit, ndërsa në përgjigje në ankesë është pranuar se në rrugën ku i është referuar ankesa është vendos posterit. Pra LDK me

prova konkrete nuk ka arritur të argumentoj se posteri është vendosur në një rrugë tjetër ku pretendon pala në ankesë, ndërsa nga pëlqimi i komunës rezulton se kemi të bëjmë me rrugë tjetër. Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK lidhur me kandidaten Bahrije Hyseni ka evituar shkeljen e pretenduar brenda afatit kohor 24 orësh dhe ka larguar posterin e vendosur në hapsirë publike në rr. Hysen Statovci” në fshatin e Vjetër në Ferizaj ka bashkangjitur fotografit ku shihet se kanë ndërmarr masa permisuese për posterat nga vendet e kontestuara.

Paneli me rastin e vendosjes së vendimit për lartësinë e gjobës ka vlerësuar rrethanë lehtësuese faktin që subjekti politikë në fjalë që ka bërë përpjekje te arsyeshme për ta evituar shkeljen - heqjen e posterit nga rruga publike, që ishte vendosur nga kandidatja për deputete Bahrije Hyseni nga radhët e Subjektit Politik LDK.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.285/2025 më datën 03.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.